



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3130 Prot.

Roskovec, më 01.07 2020

VENDIM

NR 42. DATË 29.06. 2020

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PARAQITJA DHE SHQYRTIMI I ANKESAVE, VËREJTJEVE, KËRKESAVE, PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE”.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 3/dh, neni 16/1, neni 19/1, neni 19/2, neni 20/1, neni 20/2, neni 54, gërma k, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Rregullores “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare”.
- 2- Ngarkohet Koordinatori për Konsultimin dhe Njoftimin Publik, Sekretaria e Këshillit të Bashkisë Roskovec dhe Punonjesi i Mirëmbajtjes së Rrjetit Elektronik për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare” në Bashkinë Roskovec.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA JURIDIKE DHE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. Prot.

Roskovec, më 23.06.2020

Lënda: Relacion mbi Projekt-Vendimin “ Për Miratimin e Rregullores “Paraqitja dhe Shqyrtimi i Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare”.

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Roskovec

Në mbështetje Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 3/dh, neni 16/1, neni 19/1, neni 19/2, neni 20/1, neni 20/2, neni 54, gërma k.

Paraqesim për miratim dhe diskutim rregulloren “ Paraqitja dhe Shqyrtimi i Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare”, e cila ka si objekt përcaktimin e rregullave, përgjegjësi, mënyrave dhe procedurave për ngritjen e sistemit dhe organizimin e procesit të shqyrtimit të ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare që i drejtohen Këshillit Bashkiak.

Qëllimi i saj është nxitja dhe forcimi i demokracisë vendore dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politik-bërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë.

Pikërisht të sjellë risi në adresimin e sfidave të pjesëmarrjes, të prezantojë mekanizma dhe të përcaktojë rregulla, përgjegjësi dhe procedura për t'i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit një pjesëmarrje aktive në proceset politik-bërëse dhe vendimmarrëse dhe në influencimin e axhendës qeverisëse të Bashkisë.

Kjo rregullore do të kontribuojë gjithashtu në ndryshimin e sjelles dhe të praktikave të punës së bashkive dhe në ridimensionimin e ndërveprimit e tyre me komunitetin.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi: D. Fejzulla 

Miratoi: D. Hoxha 